

V E N D I M
Nr.343, datë 3.7.1995

PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË SHËRBIMIT SHËNDETËSOR TË MJEKUT TË PËRGJITHSHËM DHE TË FAMILJES NGA INSTITUTI I SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Në zbatim të nenit 4, pika 3 dhe nenit 34 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kujdesi shëndetësor bazë sigurohet nga mjeku i përgjithshëm dhe i familjes.
2. Mjek i përgjithshëm është mjeku i diplomuar në Fakultetin e Mjekësisë që nuk ka kryer specializim pasuniversitar e që mbulon kujdesin shëndetësor bazë për të gjitha grup-moshat e pacientëve. Në këtë kategori përfshihen mjekët e fshatit dhe mjekët e blloqeve të lagjes që shërbejnë në qytet. Gjithashtu në grupin e mjekëve të përgjithshëm do të hyjnë edhe mjekët specialistë, por që punojnë si mjekë të përgjithshëm.
3. Mjeku i përgjithshëm dhe i familjes ushtron veprimtarinë e tij në qendrat shëndetësore dhe ambulancat të organizuara e të shpallura për këtë qëllim, si dhe në ambientet familjare të të sëmurit, kur është e nevojshme. Qendrat shëndetësore dhe ambulancat (godinat) për mjekët e përgjithshëm dhe të familjes shtetërore sigurohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit dhe në raste të veçanta nga organet shtetërore lokale.
4. Organizimi i shërbimit të mjekut të përgjithshëm dhe të familjes bazohet në parimin e zgjedhjes së lirë të këtij mjeku nga pacienti brenda vendbanimit të qytetit ose të komunës.
5. Pacientët në vitin 1995 mund të ndryshojnë mjekun e përgjithshëm dhe të familjes që kanë zgjedhur fillimisht vetëm pas 6 muajsh, ndërsa pas vitit 1995 pas 3 muajsh. Ky ndryshim bëhet me pëlqimin e mjekut përkatës, i cili njofton degën e sigurimeve shëndetësore në rreth.
6. Degët e sigurimeve të kujdesit shëndetësor të rretheve lidhin kontrata me mjekët e përgjithshëm dhe të familjes private dhe shtetërore. Këta të fundit konsiderohen automatikisht të kontraktuar.
7. Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit drejton kualifikimin dhe specializimin e mjekut të përgjithshëm.
8. Mjeku e ushtron veprimtarinë e tij në një territor të caktuar dhe mbulon një numër të caktuar personash. Numri i personave për një mjek caktohet nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit.
9. Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor i shtohen, dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit paraprkishtë i pakësohen: punonjës (mjekë) gjithsej 1714 veta (numri fizik), fond page e kompensim ushqimi 105 milionë lekë dhe sigurime shoqërore e shëndetësore 29 milionë lekë.
10. Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor i shtohen punonjës 107 veta, fond page 5 milionë lekë, sigurime shoqërore e shëndetësore 1,5 milionë lekë dhe shpenzime të tjera 2 milionë lekë.
- Fondet për 8,5 milionë lekë të përballohen brenda buxhetit të miratuar për Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor nga fondet e dhëna për rimbursimin e barnave.
11. Gjatë muajve korrik-gusht ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit dhe Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor të bëhet rakordimi i numrit të punonjësve (mjekëve), fondit të pagave dhe treguesve të tjerë. Në muajin shtator të paraqitet në Këshillin e Ministrave projektvendimi përkatës për diferencat që do të dalin nga rakordimi.
12. Shpërblimi i punës së mjekut të përgjithshëm dhe të familjes do të bëhet në bazë të numrit të personave të regjistruar dhe rregullave të mëposhtme:
 - Struktura e moshës së pacientëve të regjistruar te mjeku i përgjithshëm dhe i familjes.
 - Vjetërsia në punë.
 - Vështirësia profesionale.

- Vështirësia gjeografike (largësia) dhe shpenzime transporti.
- Vështirësia si inspektor sanitar.
- Shtesë funksioni.

Këto kritere do të vlerësohen në bazë të një numri të caktuar pikësh dhe vlerës së një pike.

Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor ka kompetencë të përgatitë udhëzimin e hollësishëm për shpërblimin e mjekut të përgjithshëm dhe të familjes.

13. Paga bazë mujore minimale e mjekut të përgjithshëm shtetëror, për efekt të numrit të banorëve në ngarkim, nuk lejohet të jetë më e ulët se paga bazë mujore sipas klasës përkatëse të lidhjes nr.2, me të cilën paguhet mjeku nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit.

14. Për mjekët e përgjithshëm privatë që kanë lidhur kontratë, zbatohet ngarkesa faktike për banorë të siguruar dhe sipas mënyrës së shpërblimit lekë për pikë kryhet likuidimi nga degët e sigurimeve të kujdesit shëndetësor në rrethe. Në rast se ai ka ngarkesë mbi numrin e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit, zbatohet udhëzimi i Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për shpërblimin e mjekut të përgjithshëm.

15. Mjeku i përgjithshëm dhe i familjes është i detyruar të vizitojë shtetasin edhe për rastet kur i siguruari nuk ka paguar kontributin sipas pikës 3, nenit 12 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”. Shtetasi, kur nuk ka paguar kontributin, do të paguajë një tarifë, e cila përmban shpenzimet e shërbimit të mjekut. Në rast se edhe pas vizitës pacienti nuk ka paguar tarifën, ai mbetet debitor dhe dega e sigurimeve të kujdesit shëndetësor e rrethit ka të drejtë arkëtimin e tyre sipas dispozitave ligjore në fuqi. Mjeku i përgjithshëm dhe i familjes është i detyruar të vizitojë edhe shtetas të huaj, kundrejt pagesës së tarifës.

Tarifa caktohet nga ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes së Mjedisit.

16. Mjeku i përgjithshëm që ka shtretër dhe është i punësuar në spital, do të vazhdojë të shpërblehet si deri më sot si punonjësit e spitaleve nga fondet e buxhetit lokal e nacional për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit, pavarësisht se për të plotësuar ngarkesën e punës kryen edhe vizita ambulatorë.

17. Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për vitin 1995 i shtohen 1,2 milionë lekë fond për financimin e investimeve për pajisjen e zyrave nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

18. Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, brenda muajit korrik 1995, të nxjerrë udhëzimin për administrimin e mjekut të përgjithshëm dhe të familjes.

19. Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit, organizmat e saj vartëse dhe organet e pushtetit lokal kanë të drejtë të ushtrojnë kontroll mbi mjekun e përgjithshëm dhe të familjes për zbatimin e detyrave të tij. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor përgatitin udhëzimin përkatës.

20. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ministria e Financave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.7.1995

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi